



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, seancat rifilluan më 14 gusht me dhënien e dëshmisë nga dëshmitari i 16-të i thirrur nga Prokuroria. Për dëshmitarin, dëshmia e të cilit përfundoi dje, u miratuan masa mbrojtëse dhe u mor në pyetje nga Prokuroria, Mbrojtja dhe gjykatësit. Dëshmitari i shtatëmbëdhjetë dëshmoi pa masa mbrojtëse dhe përfundoi dëshminë sot.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 21 korrik, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave dhe lejoi që bashkëshorti/bashkëshortja e një viktime pjesëmarrëse që ndërroi jetë, të marrë pjesë në vend të viktimës. Janë 140 viktima që marrin pjesë në gjykim.

Më 17 korrik, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe hodhi poshtë kërkesën e tij për lirim të përkohshëm prej dy javësh gjatë pushimit veror të gjykatës. Në arsyetimin e vet, Trupi Gjykses theksoi faktin se gjykimi në këtë çështje ka filluar, identitetet e dëshmitarëve të ndjeshëm i janë bërë të ditura Mbrojtjes së Krasniqit, dhe rrjedhimisht duhet të shmanget rreziku i kryerjes së krimeve të tjera. Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të pengojë ecurinë e procesit dhe rreziku që të kryejë krime të tjera kundër atyre që perceptohen si kundërshtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në çështjen gjyqësore dhe/ose që pritet të paraqiten para gjykatës. Trupi Gjykses konstatoi se komunikimet e z. Krasniqi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe vetëm me anën të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe arriti në përfundimin se lloji i kufizuar përkohësisht i një lirimi prej dy javësh nuk do të ndryshonte këtë përfundim.

Më 16 gusht, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Trupi Gjykses konstatoi se ekziston rrezik i mjaftueshëm që z. Thaçi dhe z. Veseli të pengojnë ecurinë e procesit dhe të kryejnë krime të tjera. Trupi Gjykses konstatoi se komunikimet mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe vetëm me anën të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Në të njëjtën çështje, më 23 qershor, Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes për të hequr një pjesë të transkriptit të dëshmisë gojore të dëshmitarit të 18 prillit 2023. Trupi Gjykses konstatoi se, megjithëse Prokuroria nuk do të lejohet të mbështetet në këtë dëshmi për të tentuar të vërtetojë përfshirjen e pretenduar personale të z. Thaçi, dëshmia mund të jetë relevante për disa pretendime juridikisht thelbësore të paraqitura në aktakuzë.

Seancat në këtë çështje gjyqësore do të vazhdojnë më 28 gusht, duke filluar në orën 9:00 paradite.





Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Kryetarja e DHSK-së caktoi Panelin e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese më 14 korrik që të vendosë në lidhje me kërkesën referuese nga z. Shala, e dorëzuar më 11 korrik, ku pretendon shkelje të të drejtave të tij themelore. Paneli përbëhet prej gjykatësve Vidar Stensland, Roumen Nenkov dhe Romina Inkuti. Kërkesa referuese ka të bëjë me konstatimin e Trupit Gjyqësor se deklaratat që z. Shala i dha policisë belge në 2016 nuk janë të papranueshme.

Më 20 korrik, Trupi Gjyqësor urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Pjetër Shalës. Trupi Gjyqësor konstatoi se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit të ecurisë së procesit dhe rreziku i kryerjes së krimeve të tjera. Trupi Gjyqësor konstatoi gjithashtu se komunikimet e të akuzuarit mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe vetëm me anën të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Seancat në çështjen gjyqësore *Shala* rifillojnë të hënën, më 21 gusht, në orën 9:30 me paraqitjen e provave nga Mbrojtësi i Viktimave.

Më 1 gusht, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë kërkesën e z. Gucati për vizitë nën ruajtje në Kosovë. Paneli i Gjykatës Supreme shqyrtoi një sërë faktesh gjatë marrjes së vendimit, dhe filloi duke theksuar se nuk ekziston e drejta e brendaqenësishme për vizitë nën ruajtje për arsye humanitare bindëse, veçanërisht në raste kur personi është shpallur fajtor me aktgjykim të formës së prerë. Paneli vuri në dukje se që nga maji 2022, z. Gucati e kishte vizituar nënën e tij pesë herë. Vizita e pestë në mars 2023 u miratua pasi ishte shpallur fajtor me aktgjykim të formës së prerë nga Paneli i Apelit dhe ai po vuante dënimin, që përfundimisht do të thotë humbjen e lirisë.

Në atë kohë vizita u miratua për shkak të rrethanave urgjente, të jashtëzakonshme dhe bindëse lidhur me shëndetin e nënës së z. Gucati. Trupi Gjyqësor vuri në dukje se bazuar në raportin e fundit shëndetësor, gjendja e nënës së z. Gucati nuk ka ndryshuar që nga ajo kohë. Për këto arsye, Paneli konstatoi se z. Gucati nuk ka vërtetuar se ekzistojnë rrethana të reja urgjente, të jashtëzakonshme dhe bindëse.

Paneli vuri në dukje gjithashtu, se ekzistojnë masa alternative të komunikimit në objektin e paraburgimit të DHS-së, përfshirë 10 vizita në muaj, që mund të jenë personale ose përmes videolidhjes, dhe kërkoi nga Administratorja të miratojë për z. Gucati videothirrje shtesë me nënën e tij, sipas nevojës.

Të gjitha parashtrimet e protokolluara publike janë të disponueshme në faqen e internetit të DHSK-së.

## Pyetje nga gazetarët

